

Dt. 31.05.2018

## Akt Themelimi

i shoqërisë tregtare **“AR-MI PROJEKTIM MBIKQYRJE” shpk**

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “ Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi nga ortakët :

1. **Z. Alket KUMARAKU**, i biri i Kristaq-it, i dtl. 09.07.1976, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, Rruga: “Xhanfize Keko”, pall. 10, ap 46, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar.
2. **Z. Arton PORO**, i biri i Anest-it, i dtl.19.05.1978, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, Rruga: “Mihal Duri”, pall. SON, ap.23, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi jurdike dhe për të vepruar.

### Formulimi

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur **“AR-MI PROJEKTIM MBIKQYRJE” shpk**.


Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

### Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare private **“AR-MI PROJEKTIM MBIKQYRJE” shpk** do të ketë selinë e saj, në rrugën “Mihal DURI”, pall.SON, ap.23, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve.

  
18  
05.31




## Objektivi i Veprimtarisë

### Neni 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e mëposhtme:

- 3.1 Projektim të punimeve të ndërtimit, rikonstruksione, mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi dhe montimi në godina civile, industriale, bujqësore, turistike, shoqërore, veprave ujore, kanalizime të ndryshme, rrugë, ura e vepra arti, punime komunale dhe të mjedisit, si dhe punime të të gjitha llojeve në fushën e ndërtimit e montimit.
- 3.2 Në drejtim të projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të objekteve sportive,interiere, peisazhi,sipërfaqe të gjelbërta lulishte dhe parqe.
- 3.3 Konsulencë inxhinierike në të gjitha fushat e inxhinierisë strukturale, hidroteknike etj.
- 3.4 Eksport-import dhe tregtim me shumicë e pakicë të të gjitha llojeve të materialeve dhe pajisjeve të ndërtimit,hidrosanitare,elektrike, te mallrave te ndryshem industriale dhe mallra të të gjitha llojeve.
- 3.5 Veprimtari e lidhur me asistencën teknike dhe asistencën inxhinierike të të gjitha shërbimeve të përmendura më sipër, etj.
- 3.6 Vlerësimi i pasurive të paluajtshme për ndërtesa dhe tokë truall. Hartimi i raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për problemet mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport vlerësimi të ndikimit në mjedise ose rezultatet e një auditimi.
- 3.7 Studimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave të cdo lloji, si dhe Hartimin e akteve të ekspertizës teknike për zjarret e rëna.
- 3.8 Projektim-zbatim konstruktiv.
- 3.9 Projektim-zbatim të objekteve të ndryshme me konstruksione metalike. Projektim dhe rievime për bazamente gjeodezike, projektme topografike dhe hartografike dhe fotogrametike. Studime gjeologo - inxhinierik i truallit për të gjitha llojet e objekteve. Studime të Sizmiologjisë inxhinierike.
- 3.10 Projektme të sinjalizimit rrugor.
- 3.11 Projektim vepra hidroteknike dhe objekte të tjera të ngjashme me karakter hidroteknik.

  
18  
05.31



## **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat 25-vjeçar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak .

## **Kapitali i Shoqërisë**

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqërisë private “**AR-MI PROJEKTIM MBIKËQYRJE**” sh.p.k., do të jetë 100.000 (njëqind mijë lekë). Kapitali është 50% nga kuotat e çdo ortaku, e ndarë në 2 kuota .

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

## **Drejtimi i Shoqërisë**

Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj dhe përfaqesuesi ligjor i saj. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj.

Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve të shoqërisë.

Neni 8

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me logon dhe tekstin brenda saj.

Neni 10

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare”, si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt themelimi, rregullohen në Statutin e Shoqërisë si dhe në legjislacionin përkatës shqiptar.





Neni 11

Akti i themelimit, u përpilua në 5 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë **“AR-MI PROJEKTIM MBIKËQYRJE”** sh.p.k.

Akti i themelimit u nënshkrua rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

Ortakët e Shoqërisë

**“AR-MI PROJEKTIM MBIKËQYRJE”** sh.p.k.

Alket KUMARAKU

*Alket Kumaraku*  
*AK*  
*18*  
*05.31*

Arton PORO

*Arton Poro*  
*AP*